


Përfundoi pelegrinazhi i Malit të Tomorrit, 500 mijë pelegrinuan

Tempulli i Tomorrit, tokës së molosëve, Dodonës Pellazgjike, tempulli i sotëm i Abaz Aliut. Histori, krenari e gjenezës sonë



Kryegjyshi Botëror, legjendari i pavdekshëm Dede Reshati që ringjalli nga varri bektashizmin, themeluesi i pelegrinazhit të Malit të Tomorrit



Ferdinand Samarxhi "Mjeshtër i Madh"



Tempulli i sotëm i bektashizmit botëror, simbol dhe krenari shqiptare



Presidenti Meta, në krenimet e mëparshme të festës në Malin e Tomorrit

NË VEND TË PROLOGUT...

Koherencë shpirtërore pandemike. Skenografi e zymtë, lëkundje ekzistenciale jete. Shpresë, Zoti, vendet, tempujt e shenjtë. Lutje profecie për jetën. Patos shpirtëror i pandalur. Qindra mijëra njerëz, pelegrinë nga të katër anët e botës si nostalgji, që vinin përtej viseve të lirisë Veriut, Jugut, vendeve skandinave, helene e përtej, ngjiten malit si ngazëllim si dikur për Apollonin.

GJENEZË E NDRITUR...

Shqiponja Deodoniane majë kreshtash, malesh epike, fluturoi gjithnjë lart, siç tha Papa Françesku më 24 shtator 2014 në vendin e nënës Terezë, Shqipëri, me besimin te Hyu u valëvit më shumë, edhe pse rrebeshe, luftëra dhe invadime të shumta popujsh kaluan nëpër të. Megjithatë të vegjël, të pabarabartë u përgjakëm, por kurrë nuk u përrulim. Shqiponjën në flamur e ngritëm si Zeusi në kohët mitike, gjithnjë për fitore.

Gjeneza Deodoniane, ndriçim, në rrugëtimin e saj.

Tempulli i Malit të Tomorrit. Tempulli i Jupiterit Thesprot, të tokës së molosëve të Dodonës së Sipërme, tempulli i sotëm i Abaz Aliut, gjeneroi në këtë truall si i pari dhe më i lashti mbi dhe.

...Kodikë qytetërimi, autoktonë të një bote të lashtë. Papë të një gjeneze, toke të lashtë, që thërrasin Omeli, Ilire.

Krishterimi, Vatikani, Papati jeton inkandeshenten e galidhësë së madhe të kombeve. Papë me origjinë ilire: Papa Shën Eleuteri (171-185), Shën Urbani i parë (222-230) e Shën Kai Papë (283-296), Papa Gjoni IV Dalmat (640-642), Papa Pali IV Karafa (1555-1559), nën drejtimin e tij botohet libri i parë në gjuhën shqipe "Meshari i Gjon Buzukut". Papa Sisti V Pereti (1585-1590). Papa Klementi XI Albani (1700-1721), me urdhër të tij u mbajt Kuvendi i Arbitrit më 10 korrik të vitit 1703, ku u mor vendimi për hapjen e shkollës së parë shqipe.

Nga ky vend shqiponjash do të lindë Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, mbrojtës i civilizimit evropian, që Papati e nderoi si atlet i Krishtit.

Nga tradita e kësaj kishe, e këtij vendi doli modeli madhështor i besimit, sakrificës, mirësisë, dashurisë e humanizmit, që modedifikoi fytyrën e një shekulli, të mbaruar me luftëra të nxehta e të ftohta. Ajo është bija e madhe e këtij kombi të vogël, e lumja Nënë Terezë. Ne jemi populli i Nënë e Terezës.

GJENEAOLOGJI E TEMPULLIT...

Tomorri, tempulli i lashtë, nis nën një gurrë mitologjike dhe ngjitet deri në thellësi të shekujve, ku vështrimi i studiuesve nuk arrin dot. Emri i tempullit të lashtë, Dodonës Pellazgjike,

Kur ju të keni arritur në tokën e molosëve të Dodonës së Sipërme, ka një Orakull të Jupiterit Thesprot ..."



Samarxhi interviston. Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: Pandemia nuk e ndali patosin e besimtarëve për tempullin e lashtë të Dodonës Pellazgjike, të Abaz Aliut të sotëm

sot Tomorrit, dokumentohet mjaft herët, që në agim të shkrimit të poemave homerike.

Eskili, shekulli V p.e.s. të "Prometeu i lidhur", fq.800, thotë: "... Kur ju të keni arritur në tokën e molosëve të Dodonës së Sipërme, ka një Orakull të Jupiterit Thesprot ..."

Në librin VI, VII, ai shprehet se tempulli i Dodonës gjendet në majë të një mali të lartë, që është Tomorri i sotëm.

Historianët, studiuesit e gjuhësisë, toponimisë, arkeologjisë mendojnë dhe e mbështesin tezën se Dodona mëmë ka qenë në Tomorr dhe bijat e saj në Janinë, Volos, Selanik dhe Itali. Dodona Pellazgjike mëmë, në Tomorrin e Shqipërisë.

Emri dhe historia e tempullit të malit të Tomorrit është e pandarë nga emri dhe historia e Dodonës, e cila është Orakulli i Zeusit. Homerit

në poemën "Iliada" thotë: "O Mbret Zeus, Dodonës Pellazgjike që banon larg duke sunduar Dodonën (Tomorrin e sotëm), që e rrahin dimra të rëndë e të egër. Këtu Zeusi deshi të ndërtohet faltorja më e vyer për njerëzinë, Orakullin e tij, Dodonën Pellazgjike".

Herodoti që e ka vizituar këtë tempull, kur flet për profecitë e Dodonës, priftëreshat e tempullit në librin e tij, thotë: "Dodona, faltorja e saj ka qenë më e vjetra nga gjithë të tjerat dhe më e para. Tempulli më i lashtë mbi dhe".

Sami Frashëri shkruan se: "... edhe në kohët më të lashta të qytetëruara të Greqisë, tempulli i famshëm i Dodonës që ndodhej në Epir, ishte dhe u përkiste pellazgëve".

...Dhe më poshtë, në librin e tij, vazhdon se: "Aty vinin për të bërë blatime, kushtime (afëromë), përveç Dodonës dhe krahinave përreth,

edhe nga popujt e Europës që ndodheshin në veri të Ilirisë.

Priftërinjtë që shërbenin në tempull, edhe popullsia në viset përreth fliste gjuhën e pellazgëve. Vizitorët që vinin nga krahinat greke ishin të detyruar të merreshin vesh me përkthyes. Popullsia e Atamanisë (Aspropotam, nahijet e Xhumrekës e të Kalaritës) ishte pellazge, paraardhës të gjenezës sonë. Qendra shpirtërore e tyre ishte tempulli i famshëm i Dodonës, Tomorrit të sotëm, quheshin Peleje (pëllumbesha), të cilat dukeshin si zogj në mes të të huajve që vijnë aty për të pyetur për fatin e tyre, pranë tempullit të Dodonës. Pelejet nuk flisnin helenisht, por guganin si barbore. Sipas mitologjisë, në Orakullin e Dodonës vinin njerëz nga të gjitha anët e botës për të mësuar për fatin tyre dhe parashikimin e tij. Tri plakat e Orakullit të Dodonës që përmend Straboni, lidhen me emrin e fisit "Graik"- "Gratë" që lokalizoheshin pikërisht në Epir. Fjala "Gra" është vendëse, pellazge, ilire, shqipe. Sipas baibit të historisë, Herodoti, feja helene e Athinës buron nga atdheu ku ndodhet Dodona, nga Arkadia, nga "Pleqtë", d.m.th. nga pellazgë, nga Epiri. Gjeneza e vendit tonë që ka pasur disa Orakuj të Zeusit, jo vetëm në trojet tona, por edhe në Libi e në Egjipt ka një Dodonë famëmadhe, disa Orakuj të Zeusit, edhe jashtë Epirote-Toske. Prej kësaj vatre, tradita e shenjtërisë së Zeusit dhe ajo e mitologjisë është përhapur në drejtim të Greqisë së sotme dhe më gjerë.


Gjithashtu, ai shkruan: "Pellazgët kishin zakon t'u flinjonin perëndive çdo gjë, sikurse mësova në Dodonë, - siç thotë ai. Pellazgët... nuk ishin vetëm një popull barbar, siç parafytyrohet për ta... për mollosët dhe arkadasit pellazgë".

Popullsia dhe vendit përreth e quajnë atë tempull në mal si vendin e profecive, - citon Gesandten Ehcric Luck@al.


Historishkronjësi i vjetër P. Aravantioit, në librin e tij botuar në Janinë në vitin 1859, pohon: "...Dodona ishte qendër pellazge, paraheleneke, shumë më e vjetër se gjuha, perënditë dhe mitologjia greke. Si e tillë, ajo u njoh në krejt botën e lashtë dhe këtë realitet ekzistues e kanë pranuar edhe vetë autorët më të mocëm helene".

"Dodona dhe Lisi, - shkruan Hesiodi VIII-VII p.e.s., - ishin qendra e pellazgëve", se hynjori Lykaon ishte i biri i pellazgut, duke përfunduar kështu thënien e Homerit shekuj më parë, se pellazgët, paraardhësit e gjenezës sonë, ishin veçse një popull hynjor, ashtu si thuhet në Bibël për popullin e Izraelit, popull i zgjedhur i Zotit.






Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, vazhdues i denjë i udhës së Dede Reshatit: Pelegrinazhi, me rëndësi të madhe botërore si dukur



Tempulli i lashtë i Dodonës Pellazgjiqe, Orakulli i Zeusit, sot tempulli i Abaz Aliut. Heroi i Luftës së Qerbelasë, Abaz Aliu



Tempulli i Dodonës Pellazgjiqe në Epir, bijë e tempullit të Dodonës Pellazgjiqe në Tomorr



Atdhe të Dodonës, tempullit, Hesiodi quan Hellopinë.

Këtu Zeusi deshi të jetë një faltore më e vyer për njerëzinë. Emri dhe vendi i Dodonës dhe krahinave përreth u quaj Hellopi, sikundër quhej edhe Eubea. Mali i Dodonës është Tomorri, rreth të cilit gjendet, siç deshi Zeusi, faltorja e tij.

Stefan Bizantini pohon se Hellopia, me të cilën lidhet emri i krahinës, është gurra mitologjike e emrit ku pozicionohet tempulli. Hellopi ishte i biri i Jonit, emri etnik i Hellowpisë, krahinë përreth Dodonës. Joni është i biri i Dyrrahut. Joni është edhe i biri i mbretit ilir, Adria, nga mori emrin deti Adriatik. Gjiri jonian është gjiri ku lindi Zeusi, deti i Kronit dhe i Reas, sipas Pierre Grimantit, vendi ku shtegtoi nimfa arkage, lo-ja e ndjekur nga Zeusi sipas Eskilit dhe Ovidit. Deti Jon, në hershmëri të thellë përfshin edhe detin Adriatik.

Pellazgu, - pohon Dionis Halikarnasi, - ishte i biri i Zeusit dhe i Niobës së Foronit. Dimë se Zeusi ka lindur në Arkadi, në viset e Shqipërisë së sotme, se Foronidha përfaqëson Jonin, Europën, një nga gratë e Zeusit, se emri i nimfës lidhet me detin Jon. Në librin e dytë ai pohon se Enea arriti në Dodonë me ushtarët më të zgjedhur për të kërkuar mendimin e perëndisë, për të gjetur ata trojanë që kishin ikur bashkë me Helenën. Enea mbërriti në vendin e enianëve, me të cilin e lidh jo vetëm emri i përbashkët, por siç duket edhe origjina. Te tempulli i Dodonës, lisi i saj, u lut Uliksi për t'u ndihmuar nga profetët për të gjetur rrugën e kthimit për në atdhe, Itakë.

...Dodona është ndërtaur, - shkruan Herodoti, - nga banorët vendës të Epirit, nga më të mocmit, pellazgët, arkadhët dhe tirretë.

Enianët, perrebejtë, - thotë Homeri tek "Iliada", - banues pranë Dodonës Pellazge, ishin pjesëmarrës në luftën e Trojës.

Straboni na mëson se orestët, banorët e Orestiadhës (krahinë e vjetër e Beratit), morën emrin nga Orestit, i biri i Agamemnonit, komandantit të ushtrisë greke në luftën e Trojës.

Pesa më e madhe e pellazgëve shkuan tek aleatët, - citon Halikarnasi, - te vëllezërit e tyre në Dodonë, ndaj të cilëve askush nuk mendonte të bënte luftë sepse ishin të shenjtë, hyjnorë. Meqenëse vendi nuk i ushqente dot, të gjithë me porosi të Orakullit të Dodonës u hodhën në Itali, në Ombri, në lumin Pad, Spine.

Pseudo Skylasi, Tuqidi, Klod Ptolemeu, Tit Livi etj., pohojnë se paraardhësit "elejtë", fis epiroi, përkatësisht ilir, u përhapën në Italinë e Jugut.

Tradita mitologjike dhe historike dëshmon se banorët e lashtë të gjenezës sonë quheshin arë, argë, arkadhë dhe më pas pellazgë, likaonë, dorë, kadmej, heraklidë, hylejtë dhe në antikitet, ilirë. Në kohët e historisë homerike, banorët e këtyre vendeve quheshin pellazgë, në antikitet epirotë dhe ilirë.

Dodona është ndërtaur në një epokë shumë të hershme në epokën mitologjike. Lidhja argë - pellazgë - dodonë - likaone - aiakas - pirrej - hyllej - heraklide - epirotë - (Thesprote-Mollose) është lidhje vertikale e drejtpërdrejtë e banorëve, e gjenezës sonë. **TEMPULLI I LASHTË I TOKËS SË MOLLLOSEVE, ORAKULLI I ZEUSIT, TEMPULLI I ABAZ ALI**

...Qerbelaja, plasdarm lufte dhe tradhtie. Gjak



Ferdinand Samarxi raporton direkt në RTSH për pelegrinazhin në pandemi të tempullit të Malit të Tomorrit, Dodonës Pellazgjiqe, Orakullit të Zeusit, tempulli i sotëm i Abaz Aliut

heronjsh. Histori trimërie e patreguar. 72 heronj, luftë përballë falangave të panumërta, Jezitit të Mavisë. Një e nga një, heronjtë bien sheit, dëshmorë. Barbari çnjerëzore. Euftrat i helmuar. Dhjetë ditë luftë marrin jetë. Buzë të çara, thara, dhjetë ditë pa ujë, vajtim foshnjash e grash pamarim. Abaz Ali, shenjtori i Qerbelasë, me dy-tre foshnja ndër duar mbi shigjeta futuron, rrymën kacakun, mëkoi foshnjat, vjen në profeci të tempullit, Dodonës Pellazgjiqe.

Tempulli i lashtë i Dodonës Pellazgjiqe lidhet me legjendën e ardhjes së shenjtorit të luftës së Qerbelasë, Abaz Ali, në Tomorr.

Siç thotë rilindësi ynë i madh, Naim



Kurbanit, rast unik, simbolik, praktik i dimensionit shoqëror dhe religjioz

Frashëri, në poemën "Qerbelaja":

...Ç'është ay që shkon kaluar, Ikën si veriu, Me dy-tri foshnja nër duar? Është! Abas-Aliu!

Mitologjia na kujton se Abaz Aliu, në tempullin e Malit të Tomorrit, Dodonës Pellazgjiqe, erdhi jo vetëm për të mëkuar foshnjat, por për t'u mëkuar vetë nga tempulli i profecive të tij, trashëgoi fuqitë e tij të mbinatyrshme e prej këtej, pas pesë ditësh shkoi në Olimp. Në



Pamje nga kremtimi i pelegrinazhit të madh botëror të tempullit të Malit të Tomorrit. Ditë dhe net pa gjumë. Njerëz që hedhin valle në tokën e tempullit, si ngazëllim për Apollonin

lëvdim dhe blatim të ardhjes dhe largimit, Abaz Aliu, shenjtor i luftës së Qerbelasë, Tomorri, shtatullat, korijet, lëndinat, faqet e tij, pelegrinohen me qindra e mijëra pelegrinë. Tomorri ngjason këto ditë me një qytetë antike, ku hedhin logun e këmbëve dhe ngazëllejën si dikur për Apollonin.

Tempulli i shenjtë i Abaz Aliut, simbol pelegrinazhit, adhurim i hershëm dhe i sotëm.

Njerëzimi që në hershmërinë e tij ka ndierë nevojën për t'u drejtuar Zotit.

Gjithnjë ka treguar forma lavdërimi për të, për shenjtoret, vendet e tyre të shenjta dhe të adhuara. Libri i Kuranit të Shenjtë, duke treguar historinë e shtatë shenjtoreve të Efisit (Ephesus) thotë: "Ne bëmë që historia e tyre të jetë publike, në mënyrë që populli të dinte që pretmiti i Zotit është i vërtetë dhe nuk ka dyshim për ardhjen e ditës së gjykimit". Ata filluan të diskutojnë me njëri-tjetrin mbi çështjen e ringjalljes dhe disa thanë: "Ndërtojmë atyre një ndërtesë (të jetë e shenjtë), Zoti i tyre di më mirë për ta (Sure El-Kehf, vargu 21, fq.342)". Ndërtesa të tilla janë ndërtaur pafund nga njerëzit, për të kërkuar bekime nga profetët, shenjtorët, dhe për të treguar respekt dhe për të praktikuar ceremonitë dhe rritualët e përcaktuara të adhurimit të tyre.

Çështja e të vizituarit të vendprehjeve të profetëve, pasuesve të tyre, shenjtorëve, ka qenë një traditë e pandërprerë, e cituar nga fjalët e Profetit Muhammed a.s., veprat dhe pohimet. Në hadithet profetike thuhet se: "Kur ta ndjeni veten ngushtë, do t'u drejtoheni vendeve të mira, ata e dinë hallin tuaj".



Pamje nga kampingu i pelegrinazhit në tempullin e shenjtë të Malit të Tomorrit, 20-25 gusht 2020, në pandemi

Vendprehja Kanotaf e Abaz Aliut është një prej shtëpive, mbi të cilën Zoti i plotfuqishëm tha: "Shtëpitë që Allahu ka shpallur që të jenë tepër të respektuara dhe emri i tij të përmendet aty me nderim, në mëngjes dhe në mbrëmje (Kurani: 24-36)". Këto vende të shenjta kanë qenë dhe janë shumë shpesh burimi i vendosjes së marrëdhënieve me Zotin. Njerëzit, duke njohur veprën e Abaz Aliut, kanë krijuar hapësirë e respektit që duhet të kenë për këtë figurë mitike, që luftoi së bashku me Imam Hysenin, krah për krah tij, kundër diktaturës së kohës, për liri dhe demokraci, për emancipimin e jetës në udhësën arabike.

Të vizitosh sot Abaz Aliun pas vdekjes së tij, është njësoj si ta vizitosh atë gjatë jetës së tij. Kjo, sepse profetët, shenjtorët, martirët janë gjallë me Zotin e tyre.

RITI I MALIT, KURBANIT, FLIJIM DHE BLATIM PËR PERËNDINË

Njeriu që në gjenezën e tij të hershme njerëzore ka ndierë nevojën që t'i drejtohet Zotit. Gjithmonë ai ka dashur të fitojë simpatinë e tij, ta ketë mbështetje dhe ndihmë.

Këtë gjë e ka shfaqur në forma nga më të ndryshmet, për të përfutur përkrahjen e tij, qoftë edhe nëpërmjet sakrificimit të vetvetes. Flijimi i njerëzve në religjionet e vjetra, primitive ka qenë shprehje tipike e besëtytnive, që ka pasur forma të tmerrshme johumane. Këto forma sakrifice, latinët i quanin "do ut des" (Jap që të më japë mua). Këto raporte në besimin islam dhe në besimet e tjera janë të panjohura.

Kurbanit është akti i flijimit sublim, i gatishmërisë së njeriut për të flijuar gjënë më të shtrënjtë, jo për t'i bërë qejfin krijesit, por për ndërtimin e porosive të fjalëve të krijuarit për mirëqenien tonë individuale dhe shoqërore. Zoti është i plotgjafueshëm, jashtëkohor, hapësiror dhe nuk është i ndikuar nga ligjet dhe rregullat e botës ekzistenciale.

Thelbin, esencën e Kuranit e shpjegon vetë Zoti në ajetin kuranor: "Tek Allahu nuk arrin as gjaku, as mish i tyre, por takvalleku juaj (devotshmëria)". Kjo do të thotë se kafsha është ndërrim simbolik me atë që njeriu duhet flijuar. Rasti i Ibrahimit a.s. që dërgoi për kurban djalin e tij, Ismailin a.s., është rast i papërsëritshëm në historinë njerëzore dhe si i tillë duhet të ndikojë inspirativisht te ne, në kohën tonë, kur po humb çdo vlerë, ku njeriu po humb të qenit njeri, si ekzistencë hyjnore e Zoti.

Vetëdija se flijimi i një pjesë të krijesave të tjera në dobi të një pjesë tjetër është çelësi i shpëtimt të një bashkësie nga shkatërrimi i

kategorive etike e besimit. Pra, kurbanit është rasti unik, simbolik, praktik i demonstrimit të besimit, që ndikon të unifikohet dimensionit shoqëror dhe religjioz.

Në këtë kontekst, tradita vazhdon në Tomorri ashtu si dikur, që beheshin kurban në blatim dhe kushturin ndaj perëndisë.

Në Tomorri, ky rit vazhdon si dimension njerëzor e religjioz.